



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:136523
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05539571

K.DH.SH.II.nr.1028/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.T.SH “Nord”, me numër identifikues 70777592 me seli ne Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat A.D., ndaj debitorit Komuna e Prishtinës, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura “Istrefi” me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1263/22 dt.29.05.2023, me datën 03.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1263/22 dt.29.05.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.69/21 dt.26.03.2021, ANULOHET Urdhri përmbarimor P.nr.69/21 dt.26.03.2021 i Përmbaruesit Privat Afet Mjeku, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1263/22 dt.29.05.2023, ne pjesën I te dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si te bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.69/21 dt.26.03.2021 te përmbaruesit Privat Afet Mjeku, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, për pjesën e detyrimit prej 189 euro dhe ne këtë pjesë procedura përmbarimore përfundohet, ndërsa ne pjesën II te dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si te pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, sa i përket detyrimit ne lartësi prej 588 euro dhe ne këtë pjesë urdhri përmbarimor P.,nr.69/2021 dt.26.03.2021 i Përmbaruesit Privat Afet Mjeku mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të cenimit thelbësor të depozitave të procedurës kontestimore dhe përbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e atakuar ta ndryshoj, ankesën e debitorit ta aprovoj si të bazuar ndërsa propozimi i kreditorit të refuzohet.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e themeltë .

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.T.SH “Nord”, me numër identifikues 70777592 me seli në Prishtinë, me datën 26.03.2021 ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit Komuna e Prishtinës, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave me nr.3-210-001-18, 16-210-001-18, 40-210-001-18, 12-210-001-19, 40-210-001-19, 52-210-001-19, 94-210-001-19, 226-210-001-19. Përbaruesi Privat Afet Mjeku nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.69/2021 dt.26.03.2021, ka lejuar përbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga faturat, t'i paguaj shumën prej 777.00 euro, me kamatë prej 8% nga dita kur ka qenë i obliguar e deri në pagesën definitive si edhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 31.03.2021, duke theksuar se propozimi për përbarim është në kundërshtim me nenin 38 dhe 40 par.1 nenpar.1.1, 1.2 dhe 1.3 të LPP, kreditori në këtë rast i ka bashkangjitur propozimit faturat të cilat nuk i plotësojnë kushtet esenciale të parapara me nenin 22 dhe 29 të LPP, i njëjti i ka bashkangjitur edhe dy fatura të cilat janë përfshirë në parashkrim. Faturat në bazë të cilave është lejuar përbarimi nuk përmbajnë elementet e detyrueshme siç kërkohet me nenin 22 të Rregullës Financiare nr.01/2013/MF-Shpenzimi i Parasë Publike dhe janë në kundërshtim me nenin 20 të UA nr.15/2010, propozon që gjykata ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, urdhrin përbarimor ta shfuqizoj, ta refuzoj propozimin për përbarim dhe të obligohet kreditori të kompensoj debitorit shpenzimet e procedurës për përpilimin e prapësimin në shumën prej 104 euro.

Ndaj prapësimin të debitorit, me datën 06.05.2021, kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke arsyetuar se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori sepse përmbajtja e prapësimin nuk përmbush asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71 të LPP, faturat janë dokumente të besueshme, debitori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi siç kërkon nenin 69 par.4 të LPP, propozon që gjykata ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të obligoj debitorin të paguaj shpenzimet në lidhje me përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 104 euro.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1263/22 dt.29.05.2023, me te cilin ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe së për dy fatura atë me nr.3-210-001-18 ne shumen prej 90 euro e arritshme me dt.30.01.2018 dhe nr. 16-210-001-18 ne shumen prej 99 euro e arritshme me dt.08.03.2018 ka gjetur se detyrimi për këto dy fatura është parashkruar marrë për bazë datën e ushtrimit te propozimit për përmbaerim nga kreditori me 26.03.2021, pra pas me tepër se tre vite nga data e arritjes për pagesë te këtyre dy faturave, gjykata ne këtë rast mbështetet ne nenin 355 par.1 dhe 2 te LMD, ashtu qe prapësimi për këtë pjesë gjënë mbështetje ne nenin 71 par.1 nenpar.1.10 te LPP, andaj për këtë pjesë gjykata përfundon procedurën konform nenit 66 par.4 te LPP. Sa i përket pjesës se dytë te dispozitivit te aktvendimit gjykata ka gjetur se urdhri përmbaerimor mbetet ne fuqi për pjesën tjetër te detyrimit sepse faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbaerimi janë te përshtatshme për përmbaerim konform nenit 29 par.3 dhe nenit 37 te LPP, kanë te gjitha tiparet e dokumentit te besueshëm dhe i plotësojnë kushtet e përcaktuara me dispozitat ligjore te sipër cekura, kanë nënshkrimin e debitorit dhe vulën e pranimit te debitorit, ashtu qe rezulton se janë dorëzuar dhe pranuar me rregull nga debitori, gjykata ka analizuar pretendimet tjera te debitorit por ka gjetur se nuk paraqesin baze ne kuptim te nenit 1 te LPP, andaj edhe ka vendosur si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkalles se dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik te gjykatës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu qe edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e shkalles se dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitat ligjore te nenit 29 par.3 te LPP-së, duke vendosur si ne dispozitiv te aktvendimit te saj sepse nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat ne lëndë, e mbi te cilën mund të iniciohet dhe lejohet procedura e përmbaerimit.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles se Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike kur vlerëson vlefshmërinë e dokumentit te besueshëm pra faturave te cilat kreditori ia ka bashkëngjit propozimit për përmbaerim duke kërkuar përmbaerimin mbi këto dokumente.

Kreditori propozimin për përmbaerim e mbështet ne dokumentin e besueshëm – Faturat nr.3-210-001-18, 16-210-001-18, 40-210-001-18, 12-210-001-19, 40-210-001-19, 52-210-001-19, 94-210-001-19, 226-210-001-19. Gjykata e shkalles e parë vlerëson se detyrimet nga dy faturat nr.3-210-001-18 dhe fatura nr. 16-210-001-18 janë te përfshira ne parashkrim ndërsa faturat tjera mbi bazën e te cilave është lejuar përmbaerimi janë dokumente te besueshme dhe konform dispozitave ligjore nga neni 29 par.3 dhe neni 37 te LPP, gjë qe me këtë përfundim te gjykatës se shkallës se parë nuk pajtohet gjykata e shkalles e dytë sepse këto fatura nuk plotësojnë kushtet

ligjore për te qenë dokumente te besueshme pasi asnjëra nga këto fatura nuk është e nënshkruar e as vulosur nga ana e debitorit Komuna e Prishtinës si institucion por disa nga këto fatura kanë vulën e institucioneve arsimore ne nivel Komunal e disa nga këto fatura janë vetëm te nënshkruara, gjë që rezulton me një mospërputhje mes debitorit nga propozimi për përmbaerim dhe institucionit që ka vënë vulën ose nënshkrimin ne këto fatura. Ne analizë te kësaj çështje gjykata e shkalles se dytë vlerëson se askund ne shkresa te lëndës nuk ka ndonjë provë se Komuna e Prishtinës ka ndonjë raport kontraktual juridik mbi bazën e te cilit do te rrjedhë me pastaj edhe detyrimi si ne fatura i Komunës se Prishtinës ndaj këtyre institucioneve arsimore ne raport me kreditorin.

Pra mbi këtë gjendje faktike del se faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbaerimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për tu konsideruar si dokumente te përshtatshme për përmbaerim, për faktin se te njëjtat nuk i plotësojnë kriteret e parapara me dispozita ligjore përkatësisht nenin 29 par.3 te LPP i cili parasheh se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaerim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Ne rastin konkret ketë fatura nuk janë te nënshkruara dhe as te vulosura me vulën e protokollit nga organi kompetent i debitorit Komuna e Prishtinës si Institucion Publik, element ky bazë që shpreh vërtetësinë dhe autenticitetin e një dokumenti, se te njëjtat janë pranuar ne mënyrë te rregullt dhe janë evidentuar ne regjistrat e institucionit nga ana e debitorit, e po ashtu nga shkresat ne lëndë nuk rezulton ndonjë provë se debitori i ka pranuar ne mënyrë te rregullt këto fatura.

Andaj, Gjykata e shkalles se dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë. Përndryshe, në procedurën përmbaerimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaerimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga këto dokumente rrjedh e drejta e organit përmbaerues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoi përmbaerimin.

Gjykata e shkalles se dytë vlerëson nenin 43 par.4 te LPP i cili përcakton se *“Përmbaeruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbaerueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbaerueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngreh kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbaerueshmërisë së nxjerrë nga përmbaeruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbaerimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaeruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbaerim nga përmbaeruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles se Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të aprovet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe urdhri për lejimin e përmbaerimit nga ana e Përmbaeruesit Privat Afet Mjeku me seli ne Prishtinë te anulohet.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1028/23, me datë 03.04.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova